ELEMENTET POSTMODERNISTE TE DISA AUTORË SHQIPTARË PAS VITEVE TË 90-ta

Haxhere AJDINI

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë
h.ajdini232937@unite.edu.mk

Abstrakt

Ky punim shqyrton elementet kryesore të postmodernizmit në letërsinë shqipe pas vitit 1990, duke u përqendruar te Rexhep Qosja, Ridvan Dibra, Zija Çela, Mira Meksi dhe Ben Blushi. Qëllimi është të analizojë mënyrën se si këta autorë artikulojnë ndryshimet shoqërore, politike dhe kulturore pas rënies së komunizmit përmes formave postmoderne. Duke analizuar veprat Vdekja më vjen prej syve të tillë, Triumfi i Gjergj Elez Alisë, Nudo, Të jetosh në ishull, SOS një buzëqeshje, Gjaku i dallëndyshes dhe Frosina e Janinës, punimi shqyrton ndërtimin e individit postmodern dhe mënyrën se si fragmentarizimi narrativ, ndërtekstualiteti, ironia dhe shumëzërësia manifestojnë shpërbërjen e identitetit. Metodat e përdorura janë induktive, deskriptive, krahasuese, aksiologjike dhe psikologjike. Rezultatet tregojnë se letërsia shqipe pas viteve '90 ndërton një model të ri rrëfimi, ku historia, miti dhe përvoja individuale ndërthuren për të krijuar një vizion të ndërlikuar mbi njeriun në periudhën kalimtare.

Fjalët kyçe: postmodernizmi, ironia, miti, dekonstruksioni, intertekstualiteti

Abstract

This paper examines the main elements of postmodernism in Albanian literature after 1990, focusing on Rexhep Qosja, Ridvan Dibra, Zija Çela, Mira Meksi and Ben Blushi. Analyzing Vdekja më vjen prej syve të tillë, Triumfi i Gjergj Elez Alisë, Nudo, Të jetosh në ishull, SOS një buzëqeshje, Gjaku i dallëndyshes and Frosina e Janinës, the study explores the construction of the postmodern individual and how narrative fragmentation, intertextuality, irony and polyphony manifest the disintegration of identity. Using inductive, descriptive, comparative, axiological and psychological methods, results show that post-90s Albanian literature builds a new narrative model where history, myth and individual experience intertwine. The conflict between tradition and modernity reveals consequences of post-communist transition – violence, power and identity crisis.

Keywords: postmodernism, irony, myth, deconstruction, intertextuality

1. Hyrja

Rënia e sistemit autoritar solli jo vetëm ndryshime politike, por edhe një evolucion të thellë në mënyrën e të menduarit dhe të të shkruarit letrar. Postmodernizmi paraqitet si koncept i ndërlikuar që sfidon përkufizimet tradicionale, duke vënë në pikëpyetje nocione si e vërteta, identiteti, historia dhe subjektiviteti.

Në kontekstin e letërsisë shqipe, postmodernizmi merr kuptim të veçantë pas viteve '90. Rënia e sistemit totalitar dhe hapja ndaj Perëndimit i dhanë fund realizmit socialist dhe hapën rrugë për forma të reja narrative, eksperimentim estetik dhe pluralizëm diskursiv . Kjo periudhë karakterizohet nga fragmentarizimi i rrëfimit, relativizimi i së vërtetës historike, ironia dhe ndërthurja e zhanreve.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë elementet postmoderne përmes veprave përfaqësuese: Zija Çela me SOS një buzëqeshje dhe Gjaku i dallëndyshes , Ridvan Dibra me Triumfi i Gjergj Elez Alisë dhe Nudo , Mira Meksi me Frosina e Janinës , Rexhep Qosja me Vdekja më vjen prej syve të tillë dhe Ben Blushi me Të jetosh në ishull .

Korniza teorike mbështetet në koncepte si intertekstualiteti, fragmentarizmi, ironia, teknika e mozaikut dhe narracioni polifonik, të analizuara si strategji për të shprehur pasigurinë e identitetit

2. Trupi i punimit

2.1 Metodat dhe mjetet

Ky punim mbështetet në metoda induktive, deskriptive, krahasuese, aksiologjike dhe psikologjike. Aparatura teoriko-kritike mbështetet te Nietzsche, Eco, Derrida, Freud, Jung, Foucault . Nga Derrida merret dekonstruksioni, nga Foucault marrëdhënia pushtet-histori-individ, nga Eco intertekstualiteti .
Metoda induktive përdoret për analiza konkrete: te Qosja nxirret realiteti historik-politik ; te Çela gjaku i çarçafit lidhet me Kanunin [5]; te Dibra lufta me Balozin zhvendoset në triumf të brendshëm. Metoda deskriptive evidenton karakteristikat postmoderne. Metoda psikologjike analizon botën e brendshme te Meksi .

2.2 Rexhep Qosja – Vdekja më vjen prej syve të tillë

Romani ndërtohet mbi strukturë fragmentare, sipas Dados më shumë si bashkim episodesh sesa strukturë lineare . Dado e quan "postmodern edhe me elemente ekzistencialiste".[1]
Në qendër është Xhezair Gjika, intelektual i përndjekur si armik i shtetit. Simbol qendror është Syri i Danjollit të Sherkës, spiun i UDB-së, që përfaqëson mbikëqyrjen e përhershme .
Frika depërton si ankth: "Natën, shpesh më zë ankthi... më del përpara syri i Danjollit të Sherkës, i zmadhuar sa një disk, i shpuar në mjedis dhe do të m'i lexojë mendimet" .
Figura e Trashes – viktimë e shoqërisë: "Atë e rrihte vëllai i saj... me konopin me të cilin ngarkonte kalin" dhe "Peshonte tetëdhjetë e dy kilogramë"[2] . Sipas Adlerit, inferioriteti është burim çrregullimi.
Elementet postmoderne: fragmentariteti, ndërthurja fakt-fiksion si historiografi metafiksionale , rrëfimtari-personazh, tipologjia me thellim psikologjik.

2.3 Zija Çela – Gjaku i dallëndyshes dhe SOS një buzëqeshje

Çela njihet për struktura jo-lineare , krahasuar me Kamy dhe Kafka.
Gjaku i dallëndyshes: Dy linja – dasma sipas Kanunit dhe vrasja: "Ajo duhet të ndodhte" . Ngjarjet në Bardhgolem, ku nderi lidhet me Kanunin. Metafora qendrore: "Ata kërkuan gjakun e çarçafit dhe gjetën gjakun e arkivolëve" . Fraza: "Në Bardhgolem, burrat që janë burra nuk pranojnë të mbajnë ndërresa të pista" . Simbolika: "Ç'i duhen këmbët dallëndyshes, ajo nuk është bërë për të ecur, po për të fluturuar" – humbja e lirisë.
SOS një buzëqeshje: Realja dhe fantazia, kalime nga e kaluara në ëndrra. "Buzëqeshja" simbolizon shpresën: "Mua më duket se goja e njeriut asnjëherë nuk i ngjet më tepër një trëndafili sesa kur buzëqesh"[3] . Dallimi: te Gjaku dramatizmi i nderit, te SOS ironia: "Unë prandaj ta dhashë si shalqinin, hape dhe shihe nëse përbrenda është i kuq ose i bardhë!"[4] .
Intertekstualiteti me Marquez , narrativë jo-lineare fragmentare.

2.4 Ben Blushi – Të jetosh në ishull

Blushi sjell mënyrë të re të rrëfimit të historisë . Periudha XV-XVIII, përballja me pushtimin osman. Islamizimi dhe pasojat. Një familje ndahet në dy fe.

[1] Dado, F. 2020. Postmodernizmi është poetikë e antirregullit. Tiranë.f.108
[2] Qosja, R. 1974. Vdekja më vjen prej syve të tillë. Rilindja, Prishtinë.f.65
[3] Çela, Z. 2000. SOS një buzëqeshje. Toena, Tiranë.f.95
[4] Çela, Z. 2000. SOS një buzëqeshje. Toena, Tiranë.f.113

Protagonisti konvertohet dhe merr emrin Ibrahim: "Islami është feja e Perandorisë dhe unë e respektoj si një shtetas i rregullt"[5] dhe "Islami dhe Krishterimi janë si hëna dhe dielli... Tani jemi në muzg" .
Pas konvertimit: "Dikush betohej se nëse pleqësia e lejonte, ai do të shkonte natën ta vriste Ibrahimin. Një tjetër tha që shtëpia e myslimanit të rrethohej me një kanal... dhe kështu ai do të jetonte në një ishull të pakalueshëm"[6] . "Të gjithë profetët janë sharë nga fshati i vet"[7].
Voskopoja si simbol i dijes: "Ne e kishim rrethuar Voskopojën me një ushtri librash" . Digjet në 1769 dhe 1789 nga Ali Pasha. Figura historike: Skënderbeu, Ali Pasha, Sabatai Zevi. Elemente postmoderne: ndërthurja mite-realitet, thyerja e linearitetit, intertekstualiteti si te Emri i Trëndafilit , teknika e mozaikut .

2.5 Ridvan Dibra – Triumfi i Gjergj Elez Alisë dhe Nudo

Dibra risjell mitet në këndvështrim modern filozofik .
Triumfi i Gjergj Elez Alisë: Ekspozicioni: "Unë shfaq vuajtjet e tij shpirtërore e ndieja kalbjen në çdo çast. Jo aq tek plagët, sesa diku brenda vetes sime"[8] . Incidenti: "Në fillim e humba dëshirën për ta parë lindjen e diellit... Tamam atëherë u shfaq fati im: Balozi!"[9] . Rritja: "Malin dhe detin i njihja, e kisha menduar krejt tjetërlloj detin, jo aq të flashkët e të qetë, thua se kishte një mijë plagë" . Kulmi: "Takimi me Balozin ndodhi shumë shpejt" . Rënia: "Ai njeri i zi vritej me fjalë, Thikën e shpatën trupi i tij vigan kishte për t' përballuar"[10] . Zgjidhja: triumf shpirtëror filozofik.
Nudo: Titulli zhveshje e shpirtit. Fillimisht Pushtimi i madh. Tema: art-pushtet-përgjegjësi. Alfredi, skulptor, drejtor i një mijë konviktoreve, vendos nudo pa kokë. E sheh konviktin si "mekanizëm përbindësh"[11] . Pushtimi simbolik i akrepave dhe minjve simbol i dëshirës për kontroll që kthehet në kaos.
Siç thotë Eco: "Tekstet postmoderne janë të hapura për interpretim të pafund"[12] .

2.6 Mira Meksi – Frosina e Janinës

Meksi kombinon historinë, letërsinë dhe psikologjinë.

Subjekti: Koha e Ali Pashë Tepelenës. Frosina si simbol i fuqisë dhe rezistencës. Dashuria e ndaluar mes Frosinës dhe Muktar Pashait. Historia e gruas si përvojë e jetuar subjektive, jo si fakt.
Tipologjia: Frosina me bagazh dije: Kant, matematikë, fizikë. Në prizmin e Jungut, figura lidhet me animus . Ali Pasha: autoritar, mishërim i patriarkalizmit. Muktari: brezi i ri që sfidon rregullat.
Intertekstualiteti: rimarrje e legjendës popullore, krahasim me hyjnesha mitologjike . Siç thotë Adler: "Inferioriteti i grave shpesh është i ndërtuar mbi baza të pakuptimta" [13]. Kur Pashai i futet në dhomë: "Frosinë, e ëmbla Frosinë"[14] dhe i premton haremin, ajo refuzon. Ai urdhëron listën e grave të përdala dhe hedhjen në liqen.

[5] Blushi, B. 2008. Të jetosh në ishull. Toena, Tiranë.f.45
[6] Blushi, B. 2008. Të jetosh në ishull. Toena, Tiranë.f.21
[7] Blushi, B. 2008. Të jetosh në ishull. Toena, Tiranë.f.56
[8] Eco, U. 1997. Si bëhet një punim diplome. Tiranë.f.133
[9]Dibra, R. 1998. Triumfi i Gjergj Elez Alisë. Onufri, Tiranë.f.149
[11]Dibra, R. 2020. Nudo. Onufri, Tiranë.f.150
[12] Eko, U. 1997. Si bëhet një punim diplome. Tiranë.f.130
[13] Adler, A. 2010. Të kuptosh natyrën e njeriut. Fatmir Dibra, Tiranë.f.160
[14] Meksi, M.2012.Frosina e Janinës.Onufri, Tiranë.f.179

Simbolika: Sënduku venecian i larë në argjend – madhështi dhe varr, uji – harresë, mëndesha – humanizmi. Momenti kur "ia doli të dëgjojë të rrahurat e fundit të zemrës së Frosinës"[15] dhe thirrja "Përgjërohem si nënë dhe vdes për dashurinë"[16].

3. Përfundimi

Elementet postmoderniste pas viteve '90 përbëjnë pikë kthese në zhvillimin e letërsisë kombëtare . Ato kanë kontribuar në krijimin e një letërsie që nuk është më nën ndikimin e ideologjisë, por që përpiqet të zbulojë dinamikën e njeriut në periudhën e ndryshimeve.
Karakteristikat më domethënëse janë ironia si mjet kritik ndaj realitetit, intertekstualiteti dhe shumëkuptimësia. Qosja dhe Çela çmitizojnë mitet kombëtare , Dibra dhe Blushi ndërtojnë rrëfime mozaike, Meksi kombinon mitike dhe historike me ndjeshmëri bashkëkohore.
Pyetjet kërkimore gjetën përgjigje: autorët ndërfutën fragmente nga tekste të tjera . Edhe pse epokat ndryshojnë, natyra njerëzore mbetet e njëjtë, viktimat dhe sistemet shfaqen njësoj brez pas brezi. Ngjarjet e së kaluarës reflektojnë sot, sepse psikologjia e pushtetit dhe e viktimave funksionon njësoj .
Letërsia postmoderne shqipe nuk kërkon të japë përgjigje të përfunduara, por të nxisë pyetje të reja. Përdorimi i intertekstualitetit krijon rrjet ku tekstet shqiptare ndërveprojnë me ato evropiane, duke e vendosur letërsinë tonë në dialog ndërkombëtar . Kjo përbën hap të rëndësishëm në modernizimin e kulturës shqiptare.

Referencat

[1]. Qosja, R. 1974. Vdekja më vjen prej syve të tillë. Rilindja, Prishtinë.
[2]. Dibra, R. 1998. Triumfi i Gjergj Elez Alisë. Onufri, Tiranë.
[3]. Dibra, R. 2020. Nudo. Onufri, Tiranë.
[4]. Meksi, M. 2012. Frosina e Janinës. Onufri, Tiranë.
[5]. Çela, Z. 1999. Gjaku i dallëndyshes. Toena, Tiranë.
[6]. Çela, Z. 2000. SOS një buzëqeshje. Toena, Tiranë.
[7]. Blushi, B. 2008. Të jetosh në ishull. Toena, Tiranë.
[8]. Dado, F. 2020. Postmodernizmi është poetikë e antirregullit. Tiranë.
[9]. Dado, F. 2003. Teoria e veprës letrare. SH.B.L.U, Tiranë.
[10]. Tirta, M. 2004. Mitologjia ndër shqiptarë. Mësonjëtorja, Tiranë.
[11]. Adler, A. 2010. Të kuptosh natyrën e njeriut. Fatmir Dibra, Tiranë.
[12]. Jung, C.G. 1989. Aspekte të femërores. Dritan Koka, Tiranë.
[13]. Aliu, A. 2016. Shkrimtar i majave letrare: mbi prozën e Zija Çelës. Toena, Tiranë.
[14]. Eko, U. 1997. Si bëhet një punim diplome. Tiranë.

[15]Meksi, M.2012.Frosina e Janinës.Onufri, Tiranë.f.180